



Kanton Zürich
Bildungsdirektion
Volksschulamt

Të mësuarit fillon shumë herët para kopshtit të fëmijëve

Rekomandime për kalim nga koha
parashkollore në kopshtin e fëmijëve



Ju doni ta përgatisni fëmijën tuaj për kopshtin e fëmijëve dhe për nivelet shkollore që vijojnë?

Për këtë nuk nevojitet diçka e jashtëzakonshme: Nëse Ju e shoqëroni fëmijën Tuaj me vëmendje dhe e përfshini atë rëndomtë në situata të së përditëshmes, atëherë kjo është përkrahja më e mirë. Kështu fëmijët fitojnë përvoja të rëndësishme mësimore, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e tyre dhe me vonë për të mësuarit e tyre në kopsht dhe në shkollë. 40 sekuenat e shkurta filmike nën: www.kinder-4.ch japin shembuj se si përditshmëria familjare mund të jetë një vend i shkëlqyer mësimi për çdo fëmijë. Zakonisht prindërit i përkrahin fëmijët e tyre sipas ndjesisë si duhet. Prandaj këshillëzat në vijim janë të menduara si përmbledhje plotësuese idesh.

Në plan të parë qëndron, që Ju të gëzoheni bashkë me fëmijën Tuaj për sukseset e tij, ti jepni kurajo përgjatë kësaj rruge dhe mundësisht duke bërë shumë gjëra vetë dhe duke i dhënë përvojë.

të folurit 	<p>A komunikoni Ju me fëmijën Tuaj? A flisni Ju me fëmijën tuaj në atë gjuhë, në të cilën ju mendoni?</p> <p>Fëmijët mund ta zhvillojnë më tej leksikun e tyre gjuhësor vetëm nëse flitet me ta dhe nëse atyre gjithashtu u jepet mundësia për të folur.</p> <p>Nëse fëmijët e mësojnë atë gjuhë, në të cilët prindërit ndjehen më të sigurtë, atëherë ata krijojnë një bazament për të mësuar edhe gjuhë të tjera. Në rastet me më shumë se sa një gjuhë që e flasin prindërit ndihmojnë vetëm rregulla të qarta, se kur cila gjuhë duhet të flitet.</p>
të dëgjuarit 	<p>A shikoni me fëmijën Tuaj libra me figura, a ia lexoni ato dhe flisni pastaj me fëmijën mbi atë që bëhet fjalë në ato? A i tregoni fëmijës përralla dhe tregime të tjera?</p> <p>Të dëgjuarit mirë dhe përqendrimi janë kushte të rëndësishme paraprake për të mësuarit në shkollë. Kjo ua lehtëson fëmijëve më vonë të lexuarit dhe të shkruarit nëse ata e përjetojnë që herët interesimin dhe gëzimin për librat, figurat/ilustrimet dhe shkrimin.</p>
të kuptuarit 	<p>A e lejoni fëmijën Tuaj që ai të prekë mundësisht shpesh gjërat (sendet) që ju përdorni përditë, ti marrë në dorë dhe ti përjetojë me të gjitha shqisat (si p.sh.: mobiljet, rrobat, thikat, pirunjtë, lugët, produktet ushqimore etj.)? A ja emërtoni dhe a ja shpjegoni këto objekte?</p> <p>Fëmijët janë kureshtarë dhe duan ta kuptojnë botën. Të kuptuarit është në të dy domethëniet e fjalës me rëndësi: të kapësh dhe të kuptosh.</p>
të formësuarit 	<p>A e lejoni Ju fëmijën Tuaj të luajë me ujë, rërë, gurëz, me gjethe, me borë, me lopata, me gota plastike etj.?</p> <p>Fëmija në këtë lojë (p.sh.: gjatë zbrazjes, mbushjes, formimit) grumbullon dijenitë a para për matematikën dhe për materialet e ndryshme.</p>

të ndërtuarit



A e lejoni Ju fëmijën Tuaj të ndërtojë dhe konstruktojë me kuba, lego, kutia etj.?

Fëmija mëson kështu ti njohë dhe ti dallojë format, madhësitë dhe sasi të.

të vizatuarit



A i jepni fëmijës tuaj letër dhe ngjyra dhe e lejoni atë të vizatojë dhe të sajojë diçka?

Kështu fëmija juaj mëson para së gjithash lëvizjet e krahut, të dorës, të gishtërinjëve, të cilat janë të rëndësishme më vonë për të shkruarit.

të formuarit



A i jepni fëmijës Tuaj letër, copëz pëlhure, kutiza, shirit ngjitës gërshërë, zam etj. dhe a sajoni Ju me të? Ose a e lejoni atë që të bëjë së bashku me Ju biskota ose t'ju ndihmojë në oficinë?

Fëmija mëson ti drejtojë lëvizjet, ai mund ta zhvillojë fantazinë e tij dhe ti realizojë idetë.

përvojat



A dilni me fëmijën Tuaj në natyrë? A e merrni atë me vete kur shkoni të bleni, në oficinë ose në dhomën e larjes? A i lejohet atij atje që ai ti prekë gjërat, eventualisht ti përdorë ata dhe njëherësh të bëhet pis?

Fëmija Juaj nëpërmjet këtyre përvojave e zgjeron dijen e tij në fusha të ndryshme dhe mëson që t'ju përmbahet rregullave.

të bërit vetë



A i lejohet fëmijës Tuaj që ai të bëjë diçka vetë – edhe nëse zgjat pak më shumë ose edhe nëse s'ja del menjëherë (p.sh.: të vishet, të shkojë në banjo, ta shtrojë tavolinën, të qërojë mollë etj.?) A e mbështesni ju atë në mendimin e tij për të gjetur mënyra zgjidhjesh dhe a e përkrahni atë që ti përballojë vështirësitë?

Fëmijëve u nevojitet kohë që të mund t'ia dalin mbanë vetë një detyrë. Pavarësia ia lehtëson fëmijës Tuaj përditëshmërinë e shkollës dhe i jep siguri në vete.

luajtja së bashku



A ka fëmija Juaj mundësi që të luajë rregullisht me fëmijët tjerë?

Fëmijët mësojnë shumë nga njëri-tjetri, gjatë të luajturit së bashku: ata mësojnë të tregojnë respekt ndaj të tjerëve dhe të dominojnë, të kuptojnë dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Kjo ja lehtëson fëmijës Tuaj që ai të ambientohet më vonë në klasë dhe të gjejë vendin e tij.

Cilat përvvoja i ndihmojnë fëmijës Tuaj, nëse shkon në kopsht të fëmijëve?

Për kopshtin e fëmijëve përveç moshës nuk ka kushte tjera për regjistrim.

Por për fëmijën tuaj është me dobi në qoftë se ai i ka kaluar përvvojat në vijim:

- të ketë luajtur, vrapuar, të jetë ngjitur dhe balancuar me fëmijët e tjerë,
- të jetë ndarë për disa orë nga prindërit e tij,
- të ketë prerë letër me gërshtë, të ketë vizatuar me lapsa dhe të ketë ngjitur me zam
- të mbathet dhe të zhveshë teshat i pavarur,
- të shkojë vetë në tualet,
- ti lajë vetë duart, gojën, hundën dhe dhëmbët,
- të kuptojë deklaratat e thjeshta në gjuhën gjermane dhe të zbatojë kërkesat
- të qëndrojë për një farë kohe mbi një gjë dhe të bëhet pjesë në të,
- të jetë treguar i kujdesshëm me gjallesat dhe materialet
- ti ketë vënë në vend sendet pas lojës – sipas nevojës edhe i ndihmuar.

Pyetje?

Në rast pyetjesh dhe pasigurie mbi zhvillimin e fëmijës Tuaj drejtoheni Ju lutemi një enti të specializuar si (p.sh.: Këshillimit familjar, mjekut pediatër (të fëmijëve), drejtorisë së shkollës ose një personelit edukator të shkollës Tuaj ose udhëheqësit të grupit të lojës të fëmijës Tuaj.

Nëse konstatohet, se ekziston zhvillim i vonuar, kërkoni ju lutemi sa më parë – para hyrjes në kopsht- bisedën me edukatoren apo kryesinë e shkollës. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet që prej fillimit përkrahja më e mirë e mundshme.

Letërsi/Burimet

- «Lernen ist schon für kleine Kinder sehr wichtig!» (Flyer der Schule Buchs SG)

Këta rekomandime janë përpiluar në bashkëpunim me shoqatën Kopshtet për fëmijë Cyrih (VKZ) dhe me shoqatën e mësuesve të Cyrihut (ZLV).



Janar 2015

Kontakt:

Bildungsdirektion Kanton Zürich

Volksschulamt | Pädagogisches, Unterrichtsfragen

Telefon 043 259 22 62, E-Mail: unterrichtsfragen@vsa.zh.ch